



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Në pajtim me nenin 107 të Ligjit Për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe në pajtim me nenin 27 të Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit shpall këtë :

K O N K U R S
PËR EKSPERTË PROFESIONAL TË PROKURIMIT DHE EKSPERTË
TË JASHTËM TEKNIK

Përmes së cilës i njoftojmë të gjithë kandidatët e interesuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit në pajtim me nenin 27 të Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, me qëllim të mbrojtjes së interesave të Autoriteteve Kontraktuese dhe operatorëve ekonomik do të përpilojë dhe mbajë regjistrin e **Ekspertëve Profesional të Prokurimit dhe Ekspertëve të Jashtëm Teknik**, të kualifikuar për shqyrtim të ankesave të Operatorëve Ekonomik, të cilët do të angazhohen gjatë shqyrtimit të ankesave dhe zbatimit të aktiviteteve të Prokurimit, konform kushteve të përcaktuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Ftohen të gjithë kandidatët e interesuar që brenda afatit të caktuar në shpallje të paraqiten me dokumentacionin përkatës në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për Ekspertë Profesional të Prokurimit janë:

1. Diplom univesitare;
2. Kandidati të ketë një dëshmi të përvojës së punës në prokurim (apo të ngjashëm);
3. E obligueshme çertifikata e prokurimit e lëshuar nga IKAP-KRPP;
4. Të jenë të paanshëm në vendosje , me ngritje të lartë profesionale dhe të kenë njohuri lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit;
5. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit).

Kandidatët duhet t'i bashkangjesin aplikacionit këto dokumente :

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer;
- Vërtetimin mbi përvojën e punës;
- Vërtetimin për punën që kryen aktualisht;
- Kopjen e letërnjoftimit.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për Ekspert të Jashtëm Teknik janë:

1. Të kenë të kryer Fakultetin e lëmive si në vijim:

- Ekonomist;
- Inxhinier të Ndërtimtarisë, Hidro, Konstruksion;
- Inxhinier të Arkitektures;
- Inxhinier të Maqinerisë;
- Inxhinier të Bujqësisë, Veterinarisë, Agrobiznes;
- Inxhinier të Gjeodezisë;
- Inxhinier të Xehtarisë;
- Inxhinier të Elektroteknikes;
- Inxhinier të Komunikacionit;
- Inxhinier të Teknologjisë Informative;
- Kimist/e;
- Farmacist/e.

2. E preferueshme është që kandidatët të kenë tri (3) vite përvojë pune profesionale ;

3. E preferueshme çertifikata e prokurimit e lëshuar nga IKAP-KRPP;

4. Të jenë të paanshëm në vendosje, me ngritje të lartë profesionale dhe të kenë njohuri lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit;

5. Mos të kenë konflikt të interesit (sipas nenit 11 të Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit).

Kandidatët duhet t'i bashkangjesin aplikacionit këto dokumente :

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer;
- Vërtetimin mbi përvojën e punës;
- Vërtetimin për punën që kryen aktualisht;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Dokumentet dorëzohen në Organin Shqyrtues të Prokurimit / Zyra e Personelit (Adresa : Rruga "Migjeni" ish-Ndërtesa e Bankës se Lublanës, Kati i V-të, Prishtinë) ose përmes e-mailit : arta.S.berisha@rks-gov.net.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati nuk do të shqyrtohen fare.

Për informata shtesë mund të kontaktoni me **Zyrën e Personelit** në numrin e telefonit : **038/212-360 prej ores 08:00 – 16:00.**

Afati i konkursit është i hapur 8 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor prej dates : 29.06.2017 deri më datën : 06.07.2017 në ora 16:00.

Pas përfundimit të përpilimit të listës së **Ekspertëve Profrsional të Prokurimit dhe Ekspertëve të Jashtëm Teknik**, Organi Shqytues i Prokurimit, do të informojë me shkrim të gjithë kandidatët të cilët kanë konkurruar për **“Ekspert Profesional të Prokurimit në OSHP dhe për Ekspert të Jashtëm Teknik”**.

Prishtinë,

29.06.2017